

KONTRATE DHURIMI KUOTASH

Në Tiranë sot më datë 24/05 2021, lidhet kjo kontratë dhurimi kuotash ("Kontrata") nëpërmjet palëve si më poshtë:

PALA DHURUESE:

Arjana Fullani – e bija e Bajram dhe Myrvete, shtetase shqiptare, lindur më 03.09.1965 në Tiranë, dhe banuese në Tiranë, me nr. Personal G55903098G, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar (këtu e më poshtë quajtur "*Dhuruesja*")

PALA PRANUESE E DHURIMIT:

Lokol Xhaja, i biri i Bajramit dhe i Myrvetes, shtetas gjerman, lindur më 14.08.1970 në Tiranë, dhe banues në Republikën Federale të Gjermanisë, mbajtës i Pasaportës Nr. C12R5XMF5 madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, (këtu e më poshtë quajtur "*Pranuesi i dhurimit*"), përfaqësuar me Prokurë të Përgjithshme Nr. 1439 Rep., Nr. 157 Kol., datë 14.07.2015 të Noteres Neriman Marika në Tiranë nga nëna e tij, Zonja **Myrvete Xhaja**, shtetase shqiptar, lindur më 03.09.1940 në Lepenicë, me nr. personal E05903070N, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar.

Meqenëse,

- A. Dhuruesja është ortakë në shoqërinë "GP Medical AL" SHPK, me NUIS: L82023006C, me seli në Tiranë, Vorë Rr. Nacionale e vjetër, Nr. 41, (në vijim referuar si "**Shoqëria**"), dhe zotëruese e një pjesëmarrjeje prej 10% (dhjetë përqind) e kapitalit të Shoqërisë e përbërë nga 1 kuote, me vlerë kapitali 10,00 Lekë;
- B. Meqenëse në mbështetje të nenit 13(5) të Statutit dhe nenit 75 të Ligjit 9901/2008 lejohet pjesëtimi i kuotës për shkak të kalimit tek persona të tretë;
- C. Meqenëse sipas Vendimit të Asamblesë së shoqërisë, i marrë me shumicën e ortakëve që përfaqësojnë $\frac{3}{4}$ të kapitalit të shoqërisë, është lejuar ky kalim i një pjese të kuotës sipas kësaj Kontrate Dhurimi;
- D. Dhuruesja dëshiron t'i dhurojë Pranuesit të Dhurimit një pjesë të kuotës së tij në shoqërinë e lartpërmendur, sipas kushteve të kësaj kontrate, dhe Pranuesi i Dhurimit është dakord ta pranojë.

Mbështetur në nenet 761 e vijues të Kodit Civil, i ndryshuar, dhe nenet 73(1)(ç), 75 e vijues të Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, palët bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1 - OBJEKTI I DHURIMIT

- 1.1. Objekt i kësaj kontrate është dhurimi pa asnjë kusht dhe kalimi në favor të Pranuesit të Dhurimit i 60% (ose 6/10) të kuotës me vlerë kapitali 6,00 (*gjashtë*) Lekë, të zotëruara nga dhuruesi në kapitalin e Shoqërisë, që përfaqësojnë 6% të kapitalit themeltar të kësaj shoqërie, nga Dhuruesi tek Pranuesi i Dhurimit.



1.2 Pas dhurimit të kuotave sipas përcaktimeve të këtij neni, ndarja e kuotave mes ortakëve të Shoqërisë është si më poshtë vijon:

1. Z. Ljuben Petrushevski, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë kapitali 50,00 (pesëdhjetë) Lekë, dhe përqindje pjesëmarrje 50 %.
2. Z. Edvin Liço, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë kapitali 40,00 (dyzet) Lekë, dhe përqindje pjesëmarrje 40 %.
3. Z. Lokol Xhaja, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë kapitali 6,00 (gjashtë) Lekë, dhe përqindje pjesëmarrje 6 %.
4. Znj. Arjana Fullani, zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë kapitali 4,00 (katër) Lekë, dhe përqindje pjesëmarrje 4 %.

Neni 2 - TRANSFERIMI I PRONËSISË

- 2.1 Dhuruesja, nëpërmjet kësaj kontrate i dhuron Pranuesit të Dhurimit pronësinë mbi 60% të kuotës së zotëruar në shoqëri, dhe zhvishet nga e drejta e pronësisë mbi këtë pjesë të kuotës, duke filluar nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontratë.
- 2.2 Me hyrjen në fuqi të kësaj kontrate, Dhuruesja do të mbetet pronare e një pjese prej 40% të kuotës së zotëruar në shoqëri, e cila i korrespondon 4% të kapitalit të shoqërisë.
- 2.3 Pranuesi i Dhurimit bëhet pronar dhe zotërues më të drejta të plota i pjesës prej 60% të kuotës së zotëruar nga Dhuruesja, që i korrespondon 6% të kapitalit të shoqërisë, sipas përcaktimit të nenit 1 më sipër, duke u bërë në këtë mënyrë zotërues i një kuote të vetme prej 6% të kapitalit të shoqërisë.


Neni 3 - DISPOZITA TË NDRYSHME

- 3.1 Kjo kontratë dhurimi hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga Palët dhe përbën gjithë marrëveshjen mes Palëve lidhur me objektin e saj.
- 3.2 Palët bien dakord që kjo kontratë dhurimi do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Për sa nuk parashikohet në këtë kontratë dhurimi do të zbatohen parashikimet e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë mbi dhurimin.
- 3.3 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të jetë kompetente për të gjykuar mosmarrëveshjet që Palët nuk mund t'i zgjidhin me mirëkuptim ndërmjet tyre.
- 3.4 Kjo kontratë dhurimi regjistrohet pranë Regjistrit Tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Kjo Kontratë Dhurimi hartohet dhe nënshkruhet nga Palët në 2 kopje me vlerë të njëjtë juridike, në gjuhën shqipe.

PALËT KONTAKUESE:

Dhuruesja:
Arjana Fullani



Pranuesi i dhurimit:
Lokol Xhaja
Përfaqësuar nga **Myrvete Xhaja**

